E mërkurë, 11 tetor 2023

[Seancë e hapur]

[Të akuzuarit hyjnë në sallën e gjyqit]

--- Seanca fillon në orën 09.02

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES Z. SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes, të gjithëve. Znj. Sekretare, ju lutem paraqisni lëndën.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Kjo është çështja KSC-BC-2020-06, Prokurori i Specializuar kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sot paradite do të vazhdojmë me dëgjimin e dëshmisë së Dëshmitarit të Prokurorisë 04577.

Për mbrojtjen e dëshmitarit, i lutem Sekretares, të na kalojë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare, ju lutem silleni dëshmitarin në sallë.

Znj. Prokurore, po.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës. Dëshiroj që ta bëj të qartë për procesverbal që ne nuk mendojmë që ka ndonjë bazë të përligjur për të bërë një ndryshim të prokurorëve.

Gjithsesi, sot do ta bëjmë këtë gjë vetëm thjesht si një

gjest i dëshirës së mirë nga ana jonë në raport me dëshmitarin dhe për mirëqenien e tij duke marrë parasysh shqetësime të caktuara të tij. Dëshmitarit do t'ia bëj unë sot paradite pyetjet.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit, znj. Lawson.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes, Dëshmitar. Dëshmitar, më dëgjoni?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kujtoj që t'i përgjigjeni pyetjeve që ju drejtohen në mënyrë të qartë dhe me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni pyetjen, lirisht mund t'i kërkoni Avokatit ose Prokurorit që të thotë dhe njëherë pyetjen ose ta sqarojë më tepër atë.

Ju lutem thoni, gjithashtu edhe bazën e njohurive dhe fakteve për të cilat do të pyeteni.

Ju lutem flisni pranë mikrofonit dhe prisni pesë sekonda përpara sesa të jepni përgjigje. Mundohuni që të flisni me një ritëm të ngadaltë në mënyrë të tillë që të kapeni plotësisht nga përkthyesit.

Duke u mbështetur në kërkesën tuaj dje, është caktuar një avokat kujdestar për juve. Ju kujtoj se mbështetur në betimin e lexuar dje, jeni i detyruar të thoni të vërtetën. Gjithashtu jeni i lirë që të konsultoheni me avokatin e caktuar,

kryesisht apo Avokatin Kujdestar apo të ngrini probleme që mund të keni me Trupin Gjykues.

Znj. Prokurore, e keni ju fjalën. Mund të filloni me pyetjet.

DËSHMITARI: W04577 [Vijon]

Pyetje nga znj. Lawson: [Vazhdim]

ZNJ. LAWSON: [Përkthim]

PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.

PË. Mirëmëngjes.

PY. Nuk jemi takuar më herët. Unë quhem Clare Lawson dhe unë do t'ju bëj disa pyetje sot paradite në emër të Prokurorisë.

PË. Në rregull.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dua që të kalojmë shkurtimisht në seancë private në mënyrë që të tillë që ti kujtoj disa aspekte dëshmitarit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Znj. Sekretare, na kaloni në seancë private për mbrojtjen e dëshmitarit.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë të hapur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Lawson, mund të vazhdoni.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Sekretare, sikurse u përmend dhe dje asnjë nga dokumentet që përmenda dhe sot dhe që u përmendën dhe dje, nuk duhet që të transmetohen për publikun.

Dokumenti i parë që kërkoj që të paraqitet në ekran është dokumenti SITF00305130, faqja konkrete që dua të paraqitet në ekran është SITF00305135. Përbri këtij dokumenti paraqisni dokumentin në gjuhën shqipe që mban numrin e identifikimit SITF00305133. Dhe faqja konkrete e këtij dokumenti është SITF00305135. Faleminderit.

PY. Dëshmitar, dokumenti që keni përpara në ekran ka të bëjë me një intervistë që keni dhënë. Shikojmë faqen ku është data 2004. A ju kujtohet të keni dhënë një deklaratë në vitin 2004?

PË. Kjo nuk qëndron. Është e pavërtetë.

PY. Po thoni që nuk keni dhënë deklaratë në vitin 2004, Dëshmitar?

PË. Po.

PY. Nëse do të shihni versionin në anglisht të këtij dokumenti, që është në të djathtën tuaj, në të djathtën e ekranit që keni përpara, a shihni emrin tuaj të shkruar në atë faqe?

PË. Këtu i paska shkarravit dikush. Këtë shkrim nuk e di kush

e ka bë. Po kjo nuk është e vërtetë.

PY. A po thoni që ky nuk është nënshkrimi juaj, po e mohoni që ky është nënshkrimi juaj?

PË. Plotësisht.

Z. DE BREE: [Përkthim] I nderuar Kryegjykatës, a mund t'i drejtohem Trupit Gjykues shkurtimisht?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

Z. DE BREE: [Përkthim] Faleminderit, z. Kryegjykatës.

Nëse më lejoni, mund të them që sot paradite, sot në mëngjes, jam konsultuar me klientin tim dhe personi që keni përpara, pra, Dëshmitari, është shumë i stresuar dhe nuk është i gatshëm që të japë dëshmi. Ai është gati që të shkojë në burg, siç jua tha dhe juve. Jam në përshtypjen që po udhëzohet ai për të dhënë dëshminë.

Nuk e di në qoftë se, nëse shtyhet seanca do të ndryshojë mendja e tij, megjithatë mbështetur në atë çfarë tha dëshmitari, do ju kërkoja që të paktën ta shtyni seancën për ca kohë në mënyrë që të kem mundësi që të konsultohem me dëshmitarin.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë ju duhet për këtë, Avokat. Pa diskutim që nuk është e paarsyeshme kjo.

Z. DE BREE: [Përkthim] 30 minuta.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në qoftë se nuk keni kundërshtime, atëherë do bëjmë një shtyrje ose pushim

prej 30 minutash.

Ndonjë nga palët ka ndonjë kundërshtim?

Në rregull atëherë. Do bëjmë pushim për 30 minuta. Merrni kohën e nevojshme për të kuptuar dhe dëshmitari duhet që të kuptojë që duhet të japë dëshmi dhe këtu ka ardhur për të dhënë dëshmi.

Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të marr fjalën pasi të dalë dëshmitari?

Z. DE BREE: [Përkthim] Duhet të qëndroj apo të dal?

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

Z. EMMERSON: [Përkthim] Mund të qëndroni.

Të nderuar Gjykatës, besoj e kujtoni nga dje që përpara sesa të thërrisni dëshmitarin --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në seancë publike. Do të kalojmë në seancë private pastaj mund të vazhdoni. Ju kërkoj ndjesë për këtë. Gabimi im.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

Z. EMMERSON: [Përkthim] Tani që jemi në seancë publike.

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në seancë publike dhe do marrim pushimin.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Tani që jemi në seancë publike, dëshiroj që të kërkoj një sqarim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, do bëjmë pushim për 30 minuta.

--- Seanca ndërpritet në orën 09.26

--- Seanca rifillon në orën 09.55

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Avokat, Avokatit Kujdestar i drejtohem, besoj se kërkuat leje të bënit një deklaratë në sallën e gjyqit.

Z. DE BREE: [Përkthim] Po, kërkova leje. Po a mund ta bëjmë në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po, do të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykata këshillon Avokatin Mbrojtës t'i shpjegojë klientit mundësinë që mund t'i jepen sanksione në bazë të rregullës 141(6) e Rregullores tonë dhe neni 42 paragrafi 7 dhe 8 i Ligjit. Shpjegojmë që kjo shtyrje pranohet pjesërisht. Dëshmitari duhet të mbetet nën juridiksionin e kësaj Gjykate në mënyrë që të jetë në dispozicion për të kontaktuar me Avokatin Mbrojtës dhe në mënyrë që të ketë ndihmë psikiatrike dhe të sigurisë nëse lind nevoja. Dëshmia e këtij dëshmitari do të rifillojë më 16 tetor të këtij viti, ditë e hënë.

Dëshmitar, nuk duhet të diskutoni dëshminë tuaj me asnjë person përveçse me Avokatin Kujdestar që është caktuar për ju. E kuptoni këtë? Thjesht "po" ose "jo".

DËSHMITARI: Z. Gjykatës, unë e kuptoj. Po kuptomëni edhe mu ju që mu më duhet një muaj ditë kohë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo.

DËSHMITARI: Nëse nuk ka një muaj ditë kohë atëherë, ju i dini masat e juaja edhe vazhdoni procesin. Edhe drejtomi ato kur unë ju thashë më herët. Në burg edhe s'ka tjetër.

Gjendja jeme nuk është e mirë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit. Faleminderit. Keni Avokatin këtu. Avokati do jua shpjegojë vendimin tonë dhe do jua shpjegojë kur të mos jemi ne të pranishëm dhe pyetjet mund t'i bëni me Avokatin tuaj. Dhe ndërpresim seancën sa i takon dëshmisë suaj.

DËSHMITARI: Okej.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Asistente, shoqëroni dëshmitarin.

Avokat, faleminderit që ishit i pranishëm.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Mund të qëndrojë një çast Avokati.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për çfarë qëllimi?

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po dua të sqarojë diçka.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, jo do largohet. Sqaroheni me ne.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po ka lidhje me Avokatin Mbrojtës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pak më konkret.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Avokati e bëri të qartë në mëngjes që nuk e njeh fare çështjen. Ju po i thoni atij që ai të këshillojë klientin, pa diskutuar asgjë --

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Është ai Avokati Mbrojtës, le ta bëjë ai punën siç di ai. E njeh, e njeh ai punën, e njeh dhe detyrimin që ka si avokat dhe nuk jeni ju personi që duhet ta udhëzoni si të bëjë punën.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po s'po bëj këtë gjë dhe më ofenduat me këtë që thatë dhe duhet ta tërhiqni këtë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk do të tërheq asgjë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Unë po them, duke qenë se ai nuk e njeh çështjen. Ju po thoni që ai nuk duhet të kontaktojë fare Prokurorinë për të marrë informata?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po unë nuk e zura fare në gojë këtë. Nuk po e zgjasë më. E mbyll seancën.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po nëse na kontaktojnë për këshilla dhe ndihma të paktën për materialet, ju po thoni që ne nuk duhet të flasim me Avokatin?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Me dëshmitarin jo.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po jo me dëshmitarin, me Avokatin.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po e vendos vetë Avokati Mbrojtës. Po them vendos vetë Avokati Mbrojtës.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po ju thatë më herët që nuk duhet të kontaktojmë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po nuk thashë

unë që s'duhet të ndodhë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Domethënë, në qoftë se ai kontakton palët për sqarime nuk ka asnjë problem?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse lind nevoja që ai ta bëjë këtë si Avokat Mbrojtës mund ta bëjë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Këtë doja të dija dhe unë. Nuk ishte nevoja për të hedhur akuza këtu.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirë. Me sa kuptoj unë kemi një dëshmitar gati në mënyrë që të organizohemi për të filluar me dëshmitarin e radhës. Le të sjellim dëshmitarin e radhës. Faleminderit.

Oh, ju kërkoj ndjesë, z. Ellis.

Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kemi një problem. Ne të enjten u njoftuam që kishte dy dëshmitarë për këtë javë. Po nuk na thanë që kishte dëshmitarë rezervë, dinim dy dëshmitarët që patëm, nuk jemi të përgatitur për kundërpyetjet e dëshmitarit të radhës.

Ne kishim parashikuar që do vazhdonim me dëshmitarin e sotëm gjatë gjithë javës. Madje edhe siç u zhvilluan gjërat, ne Prokuroria nuk na njoftoi në asnjë moment që kemi gati dëshmitarin e radhës që të fillojmë me dëshminë. Duhet ta kuptoni që ne kemi pasur të gjitha burimet të angazhuara m e këtë dëshmitarin.

Z. KEHOE: [Përkthim] E mbështes dhe unë. Ne kemi pasur shumë materiale voluminoze për dëshmitarin dhe nuk e dinim që

kishim dëshmitar rezervë për këtë javë. Siç tha edhe z. Ellis, ne na thanë që këtë javë do të kishim vetëm dy dëshmitarë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] A mund të them dhe unë diçka? Në përputhje me udhëzimet tuaja ne kemi ndarë përgjegjësitë brenda për brenda ekipit sa u takon pyetjeve tona. Dhe është përgjegjësia ime të bëja pyetjet dëshmitarit që iku por edhe dëshmitarit të radhës.

Po duke pasur parasysh zhvillimet e këtyre dy ditëve, ka qenë e pamundur që të përgatiteshim për kundërpyetjet e dëshmitarit të radhës. Mund të jem gati nesër paradite për të bërë kundërpyetje. Nëse përfundon Prokuroria me pyetjet e veta po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sa kohë keni parashikuar ju për këtë dëshmitar?

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Besoj se tre orë, po më duhet ta verifikoj këtë informacion.

Po dua të them diçka tjetër. Nuk është dëshmitar rezervë. Ishte thjesht dëshmitari i radhës në këtë bllok dëshmitarësh dhe njoftimi për këtë dëshmitar është nxjerrë të hënën edhe materialet në prezantim janë materialet në listën -- lista e materialeve është përgatitur dje.

Z. KEHOE: [Përkthim] Po sigurisht ne si Avokatët Mbrojtës duhet të përgatitemi, ne u njoftuam që këtë javë do kishim vetëm dy dëshmitarë.

Vjen informacioni përgatitemi për dëshmitarin dhe për

këtë dëshmitar jemi përgatitur për javën tjetër, jo këtë javë. Ne patëm shumë informacione voluminoze për dëshmitarin e sotshëm, kështu që të gjitha burimet i kishim të angazhuara.

E kuptoj që ju e keni shqetësim kohën. Po kjo është shqetësuese për Mbrojtjen se me sinqeritet ditët e fundit kemi punuar vetëm për këtë dëshmitar.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson ka thënë që mund të presë deri nesër dhe t'i bëjë ai kundërpyetjet, mbase kështu mund të funksionojë.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] Dy orë. Dy orë na nevojiten.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Unë doja tre.

ZNJ. LAWSON: [Përkthim] E bëjmë dhe tre.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Atëherë kështu do të veprojmë. Mund të fillojmë me pyetjet e Prokurorisë dhe mund të vazhdojë z. Emmerson.

Sa orë kërkoni ju, z. Emmerson?

Z. EMMERSON: [Përkthim] Nëser, rreth tre orë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nesër është e enjte. Nesër deri në orën 1.00 punojmë sidoqoftë. Nuk kemi seancë të tretë.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Atëherë nëse mund të filloj unë me kundërpyetjet nesër paradite, kështu do të veprojmë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Këtë do të bëjmë. Ju faleminderit për bashkëpunimin.

Duhet të largohemi pesë minuta.

Z. ELLIS: [Përkthim] Po si, çfarë do ndodhi me dëshmitarin që sapo iku? Se ai me sa kuptova do vij të hënën. Pra, ne s'do e mbarojmë dot dëshmitarin dot deri të hënën.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, nuk do ta mbaroni dot. Do të qëndrojë në pritje derisa t'i vijë radha përsëri.

Z. ELLIS: [Përkthim] Që të jemi të qartë, unë nuk jam gati t'i bëj pyetje dëshmitarit nesër. Nuk ka kohë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka problem.

Mirë. Dhjetë minuta të organizoheni dhe kthehemi në sallën e gjyqit.

--- Seanca ndërpritet në orën 10.37

--- Seanca rifillon në orën 10.48

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellsi.

Z. ELLIS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, ka një çështje që rrjedh elementi që diskutuam pak më herët, nuk kam pasur mundësi që të diskutoj me znj. Lawson që është përballë nesh dhe ka të bëjë me dokumentet e renditura nga Prokuroria për sa i takon dëshmisë.

Dhe sikurse e thashë edhe më herët, nuk kam mundësi që të bëhen pyetjet, kundërpyetjet prej meje për dëshmitarin e radhës, kështu që do më duhet deri të hënën në mënyrë që të jem gati për të bërë kundërpyetje për dëshmitarin, në qoftë se kjo pranohet.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë kundërshtim?

Z. KEHOE: [Përkthim] Jo.

Z. EMMERSON: [Përkthim] Po, unë po filloj të premten -- nesër, jo të premten por synimi është që materialet e Mbrojtjes së Veselit të mund t'i ngarkojmë në sistem përpara sesa të fillojmë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për të tre Ekipet e Mbrojtjes zgjatet koha deri të hënën, në përjashtim të z. Emmerson.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do kërkoja gjithashtu që edhe unë të filloja të hënën sepse z. Emmerson kërkoj tre për nesër dhe unë jam planifikuar që të jem i dyti që t'i bëjë kundërpyetje këtij dëshmitari pas z. Emmerson. Kështu që do kërkoja që edhe unë të kisha mundësinë që t'i bëja pyetje dëshmitarit të hënën.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në përjashtim të rastit që do ishte më i shkurtër se kaq z. Emmerson, megjithatë do shikojmë sesi do shkojë.

Znj. Sekretare, ju lutem shoqëroni dëshmitarin në sallë.

Znj. Sekretare e Seancës, mund të paraqisni lëndën.

[Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit të radhës. Sot do të dëgjojmë dëshminë e Dëshmitarit të Prokurorisë W04769, jemi në

seancë publike aktualisht.

Më dëgjoni, Dëshmitar?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Sekretare e Seancës, do t'ju japë një tekst të deklaratës solemne dhe ju duhet që të lexoni këtë betim solemn në pajtim me rregullën 141(2) të Rregullores së Dhomave të Specializuara të Kosovës. Ju lutem hidhini një sy dokumentit dhe lexojeni me zë tekstin që keni përpara.

DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe nuk do mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

DËSHMITARI: W04769

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të uleni, Dëshmitar.

DËSHMITARI: Faleminderit.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dëshmitar, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj që planifikohet që të zgjasë për disa ditë. Sikurse mund ta dini, e para që do t'ju pyetje është Prokuroria. Pasi të ketë përfunduar me pyetjet Prokuroria, Mbrojtësi i Viktimave ka të drejtë për t'ju bërë pyetje ju, po ashtu kanë të drejtë që të bëjnë pyetje ekipet e Mbrojtjes, si dhe anëtarët e Trupit Gjykues.

Prokuroria ka vlerësuar se i duhen dy orë për t'ju marrë

në pyetje. Vlerësimet e Mbrojtjes janë që do i duhen në mënyrë të përgjithshme 13 orë. Si në rastet e dëshmitarëve të tjerë, ju kërkojmë Mbrojtësve të të akuzuarëve që të jenë efecient në përdorimin e kohës së sallës së gjyqit. Trupi Gjykues mund të lejojë gjithashtu edhe pyetje plotësuese në qoftë se përmbushen kriteret përkatëse.

Dëshmitar, ju lutem përgjigjuni në mënyrë të qartë me fjali të shkurtra. Nëse nuk e kuptoni pyetjen, thojini Avokatit ose Prokurorit që nuk e kuptoni pyetjen në mënyrë që të mund të përsëritet dhe njëherë apo të shtjellohet më tej pyetja.

Po ashtu, ju lutem na thoni bazën e njohurive dhe të rrethanave për pyetjet që do t'ju bëhen.

Në qoftë se ZPS-ja ju kërkon që të bëni korrigjime të dhëna në deklaratat e mëhershme tuajat, kujtohuni që duhet të konfirmoni në procesverbal që deklaratat e mëhershme janë korrigjuar dhe se korrigjimet bashkë me deklaratat, pasqyrojnë në mënyrë të saktë dëshminë tuaj.

Ju lutem flisni pranë mikrofonit, bëni një pauzë prej pesë sekondash përpara sesa t'i jepni përgjigje pyetjeve dhe kjo bëhet në mënyrë të t'i jepni kohën e përshtatshme përkthyesve për t'ju kapur plotësisht.

Gjatë kohës që jepni dëshmi përpara Trupit Gjykues nuk lejoheni që të diskutoni për përmbajtjen e dëshmisë jashtë kësaj salle gjyqi me askënd. Kjo është e vërtetë dhe pasi të

keni përfunduar dhënien e dëshmisë. Nëse dikush ju pyet jashtë kësaj Gjykate lidhur me dëshminë e dhënë në sallën e gjyqit, ju lutem na e bëni me dije këtë gjë.

Në fund, dëshiroj t'ju them që nëse ju them ndaloni së foluri, duhet që të ndaloni përnjëherë së foluri, ose në qoftë se e ngre dorën në këtë mënyrë siç e ngrita tani, ju lutem mos flisni më. Se kjo do të thotë që duhet t'ju jap udhëzime të mëtejshme. A e kuptoni këtë, Dëshmitar?

DËSHMITARI: Po, të gjitha i kuptoj.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nëse e keni të nevojshme që të bëni ndonjë pushim në çdo kohë ju lutem na e thoni këtë gjë dhe ne do të bëjmë më të mirën tonë që t'ju japim një pushim.

Tani do të fillojmë me Prokurorinë.

Zotëria, Prokurori do t'ju bëjë pyetje.

Prokuror, fjala për juve.

Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, i nderuar Gjykatës.

Përpara sesa të fillojmë me marrjen në pyetje të dëshmitarit, dëshiroj që t'ju pyes që kur do ta bëjmë pushimin?

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përkthyesit kanë që në orën 9.00 që flasin. Kështu që ne pushimin do ta bëjmë siç e kemi bërë çdo ditë tjetër. Domethënë, duhet të keni pesë minuta përpara sesa të bëjmë pushimin dhe pastaj mund të vazhdojmë me pjesën tjetër.

Doni që të kalojmë në seancë private?

Z. HALLING: [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem Sekretare, na kaloni në seancë private për mbrojtjen e identitetit të dëshmitarit.

Në qoftë se dëshironi mund të lexoni përmbledhjen.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës. jemi në seancë të hapur.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Mund të vazhdoni.

Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

PY. Tani jemi në seancë të hapur, Dëshmitar. A jeni intervistuar më herët nga ZPS-ja?

PË. Po.

PY. Kërkojmë që dokumenti që paraqitëm më përpara të paraqitet sërish në ekran, është dokumenti 074788-TR-AT Pjesa 1 E Rishikuar RED2, faqja 1 e këtij dokumenti. Ju lutem paraqiteni në të gjithë ekranin të zmadhuar.

PY. Dëshmitar, a është kjo intervista që i keni dhënë ZPS-së?

PË. Po.

PY. A keni pasur mundësi kohët e fundit që të njiheni dhe një herë me përmbajtjen e kësaj interviste?

PË. Po.

PY. Në seancën përgatitore javën që shkoi dhe në fillim të kësaj jave me ZPS-në, juve bëtë disa sqarime dhe disa korrigjime të kësaj interviste, a është e saktë kjo?

PË. Po.

PY. Këto ndryshime janë pasqyruar në një shënim që ju lexua juve më pas, ka ndodhur kështu apo jo?

PË. Po.

PY. A konfirmoni që ajo çfarë ju lexuam mbrapsht juve në këtë

shënim pasqyron korrigjimet dhe ndryshimet që ju keni bërë në mënyrë të saktë?

PË. Po.

PY. Duke përfshirë ndryshimet që ju keni dhënë në atë shënim, dëshminë që i keni dhënë ZPS-së a pasqyrojnë me saktësi dhe vërtetësi atë çfarë do thonit juve po të pyeteshit për të njëjtat gjëra këtu përpara Trupit Gjykues?

PË. Po.

Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, pasi kemi përmbushur kriteret e rregullës 154 dhe në përputhje me vendimin F001700, ZPS-ja kërkon që të regjistrohen në prova materiale të gjitha pjesët e intervistës së ZPS-së dhe Shënimi Përgatitor 1 që është dokumenti me ERN 116066 deri në 116071.

Gjithashtu kërkojmë që të pranohen në prova materiale dokumentet shoqëruese në intervistë, në qoftë se është e nevojshme mund t'i përmendim njëra pas tjetrës të gjitha këto materiale shoqëruese, por këto materiale shoqëruese janë dhënë në poshtëshënimin 133 të vendimit tuaj, të nderuar Gjykatës, të rregullës 154 përveç një transkripti që është 01179506-TR-F01770 dhe përkthimit në anglisht. Dhe ERN e fundit është numri i transkriptit të përkohshëm.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka ndonjë kundërshtim?

Z. KEHOE: [Përkthim] Përveç kundërshtimit të mëhershëm që ka të bëjë me mocionin 154, nuk kemi kundërshtime të tjera.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Kam një kundërshtim të vogël lidhur me shënimin përgatitor me sa e kam kuptuar unë shënimi përmban informacion të ri që nuk ka të bëjë me sqarime ose me korrigjime të deklaratave të mëhershme, po ka të bëjë me informacion të ri sipas deklaratës 154.

Informacioni është konfidencial, nuk mendoj se mund ta diskutoj në seancë të hapur, por e kam fjalën konkretisht për paragrafin 8 të shënimit përgatitor të ZPS-së. Një pjesë e këtij paragrafi. Për procesverbal është dokumenti ERN 116066 deri në 116071.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A keni diskutuar këtë gjë ndërmjet jush, ndërmjet palëve?

ZPS-ja.

HALLING: [Përkthim] Është hera e parë që e diskutoj këtë gjë.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Ngaqë dëshmitari erdhi më herët sesa ishte parashikuar. Nuk e kemi diskutuar dot me Prokurorinë këtë gjë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk dua t’i hedh fajin askujt po thjesht po pyesja.

Z. ROBERTS: [Përkthim] Do të mund ta diskutojmë gjatë pushimit, në qoftë se është e nevojshme.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Ellis, keni ndonjë kundërshtim?

Z. ELLIS: [Përkthim] Jo, nuk kemi kundërshtim.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Emmerson, keni ndonjë kundërshtim?

Z. EMMERSON: [Përkthim] Jo.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Atëherë do të pranojmë dokumentin 074788-TR-ET Pjesa 1 të Rishikuar dhe Shënimin Përgatitor në përjashtim që paragrafit 8 që u përmend më herët.

[Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës këshillohen]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do i lexojmë provat shoqëruese pas pushimit dhe do të merremi me kundërshtime të tjera që mbase mund të kenë të bëjnë me paragrafin 8.

Z. HALLING: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi të përgatitur ta lexojmë tani përmbledhjen në qoftë se na lejoni.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për përkthyesit, dua t’i njoftoj që do t’ju lexoj përmbledhjen dhe pastaj do bëjmë pushimin.

Z. HALLING: [Përkthim] Përmbledhja i është komunikuar Mbrojtjes dhe nuk kemi kundërshtim në përjashtim të asaj çfarë -- dhe nuk prek atë çfarë tha Mbrojtja e z. Selimi.

W04768 është ish-ushtar i UÇK-së që ka njohuri për strukturën komanduese të UÇK-së në Shqipëri edhe në zonën e Pashtrikut. Ai ka njohuri për personat e pranishëm në takimet e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së në vitet 1998 dhe 1999,

përfshirë të akuzuarit.

04769 mbështet vrasjen e një viktime të akuzuar në aktakuzë në Kleçkë si dhe dëshmia e tij ka të bëjë me figura të njohura të UÇK-së dhe krimet që kanë ndodhur në Prizren në qershor të vitit 1999.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull. Do bëjmë pushimin, në mënyrë që t'ju japim kohë përkthyesve që të bëjnë një pushim dhe do të fillojmë më pas me dëshminë tuaj.

Dëshmitar, ju lutem nuk duhet të diskutoni me askënd jashtë sallës së gjyqit për dëshminë tuaj. Mund të dilni nga salla. Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jemi në seancë publike. Do bëjmë pushim për 30 minuta. Do mblidhemi përsëri në orën 12.00 pa 20.

--- Pauza fillon në orën 11.08

--- Seanca rifillon në orën 11.40

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Asistente, ju lutem silleni dëshmitarin.

Z. HALLING: [Përkthim] Përpara sesa të sillet dëshmitari. Thjesht duam që t'ju përditësojmë lidhur me konsultimet *inter partes* me Mbrojtjen e Selimit, mund ta themi edhe në seancë të hapur. Pjesa e diskutuar në paragrafin 8, ajo për të cilën u pajtuam me Mbrojtjen e Selimit - dhe ju lutem më korrigjoni z.

Roberts në qoftë se nuk është kështu – unë do të përpiqem që të nxjerr të njëjtin informacion nga dëshmitari në këtë seancë. Në qoftë se do t'ia dal që ta nxjerrë këtë formacion në mënyrë të drejtpërdrejtë atëherë do zgjidhet çështja.

Në të kundërtën do shohim se çfarë do ndodhë e do të vendonim për pranueshmërinë apo jo të këtij paragrafi prej jush, të nderuar Gjykatës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Mund ta sillni dëshmitar në sallë.

[Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës këshillohen]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, për t'ju caktuar numrat dokumenteve të pranuar në prova materiale do të fillojmë me deklaratat me numër identifikimi ERN 074788-TR-AT Pjesa 1 RED2 dhe transkriptin në shqip për të njëjtin dokument është prova materiale 492.1. Pjesa 2 e dokumentit me të njëjtën ERN do të jetë prova materiale P492.3. Pjesa 3 nga i njëjti material është prova materiale P492.3. Pjesa 4 e deklaratës do të marrë numrin e provës materiale P492.4. Pjesa 5 do të marrë numrin e provës materiale 492.5.

Më pas shënimi përgatitor që identifikohet me numrin 116066 deri në 116071 do të marrë numrin e provës materiale 495.

Provat shoqëruese 0747488 deri në 074787 do të marrë

numrin e provës materiale 496.

Dokumenti ERN U0006497 deri në U0006504 do të marrë numrin e provës materiale 497.

Dokumenti U0023339 deri në U0023340 do të marrë numrin e provës materiale 498.

Dokumenti U0005851 deri në U005851 do të marrë numrin e provës materiale 499.

SITF00021875 deri në SITF00021876 do të marrë numrin e provës materiale 500.

Dokumenti 054010 deri në 03, fragmenti i asaj videoje nga minuti 00 deri në minutin 05 deri në sekondën e 07 [05:07], do të marrë numrin e provës materiale P501.

Videoja me ERN 011795 deri në 06 dhe fragmenti përkatës nga minuti 04:55 deri në 05:07 dhe transkripti që u paraqit nga Prokurori sot më herët paradite, që është pjesë e dokumentit 011795 deri në 06-TR, parashtrimi i protokolluar F01770 do të marrë numrin e provës materiale 502.

Dhe videoja e fundit, që identifikohet si 068357 deri në 01, pjesa 00:10 deri në 00:54 do të marrë numrin e provës materiale 503.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

Edhe një gjë tjetër. Z. Kehoe, kishit një listë të provave materiale që donit të paraqisni. Do ta bëni sot apo jo?

Z. KEHOE: [Përkthim] Do e diskutoj këtë me kolegët nga

ZPS-janë diskutime *inter partes*.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pa problem. Thjesht sa për t'u kujtuar e thashë këtë gjë.

Z. KEHOE: [Përkthim] Po, kolegët në fakt sapo më kujtuan lidhur me të njëjtën gjë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Sekretare, mund ta sjellës dëshmitarin në sallë.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Na dëgjoni mirë, Dëshmitar?

DËSHMITARI: Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling, fjala për ju.

Z. HALLING: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës. Do kërkojmë që të kalojmë në seancë private. Dhe planifikojmë që të qëndrojmë në seancë private për ca kohë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] për të mbrojtur dëshminë e dëshmitarit?

Z. HALLING: [Përkthim] Po.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund të kalojmë në seancë private për mbrojtjen e identitetit të dëshmitarit, znj. Sekretare.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, jemi në seancë publike.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do bëjmë

pushimin e drekës.

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.01

--- Seanca rifillon në orën 14.30

Z. HALLING: [Përkthim] Kemi për të diskutuar diçka në lidhur me organizimin, në qoftë se na jepni leje.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Një çast, tani mund të flisni.

Z. HALLING: [Përkthim] Ka pasur shumë interes nga Mbrojtja sa i takon dëshmitarëve të javës tjetër, duke marrë parasysh vendimin 1851 dhe urdhrave që u dhanë sot paradite.

Vetëm për procesverbal do të them, do ju çojmë edhe një postë elektronike, ne po parashikojmë që të bëjmë një ndryshim të dëshmitarëve për javën e radhës. Si fillim, të përfundojnë dëshmitarët që ishin llogaritur për këtë javë, dhe dëshmitari i seancës së sotme, dhe pastaj në qoftë se është nevoja, të vijë dëshmitari rezervë 00208.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

Asistente, mund të sillni dëshmitarin.

[Dëshmitari vijon dëshminë]

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull, dëshmitar. Mirë se erdhe. A më dëgjon mirë?

DËSHMITARI: Po, shumë mirë.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Halling ka pyetje të tjera për ju.

Z. HALLING: [Përkthim] Po, kam shumë pak pyetje, por do

të doja që fillimisht të kalonim në seancë private.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

Z. ELLIS: [Përkthim] Sa i takon pjesëmarrjes ka mundësi

që z. Krasniqi nesër ta ndjekë me videolidhje. Do bëjmë kërkesën përkatëse pas seancës.

KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Nuk ka aspak problem.

Ju faleminderit të gjithëve, shihemi nesër në orën 9.00.

--- Seanca mbyllet në orën 15.37